

*2 maj 2014, Prishtinë*

**KOMUNIKATË PËR MEDIA  
Hapat e parë në hartëzimin e ndërtimeve pa leje në Prishtinë**

Si pjesë e projektit “Transparenca online e komunës së Prishtinës”, EC Ma Ndryshe, në muajt e parë të këtij viti, ka hartuar dhe testuar një metodologji për evidentimin dhe hartëzimin e ndërtimeve pa leje. Objektivat kryesorë të kësaj metodologjie ishin skanimi i ndërtimeve në terren, identifikimi dhe regjistrimi i shkeljeve dhe paraqitja e shtrirjes së tyre në mënyrë grafike në hartë. Qëllimi i këtij evidentimi është bërja publike e shkeljeve ndërtimore në qytetin e Prishtinës por edhe rritja e nivelit të transparencës së Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës.

Komponenta të rëndësishme të kësaj metodologjie janë: evidentimi i gjendjes faktike në terren; analiza e planit rregullues të fundit të lagjes së trajtuar (por edhe i atyre detaje, aty ku paraqitet nevoja) dhe dokumentacionit tjetër (ortofoto, etj); analiza e lejeve të lëshuara për secilin objekt në lagjen e trajtuar, por edhe të kërkesave për leje; nxjerrja e të dhënave nga evidencat e inspeksionit të ndërtimit për lagjen e trajtuar dhe nxjerrja e të dhënave nga regjistri kadastral dhe i pronës. Testimi i metodologjisë u krye në Lagjen Pejton të qytetit të Prishtinës, ndërsa të dhënat e tjera u mbledhën pjesërisht përmes kërkesave për qasje në dokumente publike në drejtoritë përkatëse në komunën e Prishtinës. Metodologjinë e hartëzimit, por edhe të dhënat e mbledhura deri më tani për lagjen pilot, EC Ma Ndryshe ia dorëzoi Drejtorisë së Urbanizmit të komunës së Prishtinës, me kërkesën për plotësime të mëtutjeshme dhe implementimin e saj.

Për të vazhduar adresimin e problemeve të kaosit urbanistik në qytetin e Prishtinës, por edhe për ta përditësuar dhe pasuruar metodologjinë me ndonjë komponentë shtesë, EC Ma Ndryshe planifikon që ta zbatojë këtë metodologji evidentimi të ndërtimeve pa leje në së paku edhe dy lagje të Prishtinës. Projekti i monitorimit të transparencës së komunës së Prishtinës (me fokus në urbanizëm) synon ngritjen e nivelit të transparencës lokale në vendimmarrje përmes monitorimit të ekzekutivit dhe raportimit për praktikën e vendimmarrjes lokale.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së komunës së Prishtinës do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prishtinës do të publikohen në ueb-faqen e projektit, [www.online-transparency.org](http://www.online-transparency.org).

Ju falemnderit,

Rozafa Basha, koordinatore projekti  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Saraçët, Nr. 5 – Prizren  
Rr. Perandori Dioklecian 14 Kati V (te Qafa), Prishtinë 10000  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy  
Pristina

*Projekti "Transparenca Online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës"  
përkrahët financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*